



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike / Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
/ Kosovo Academy for Public Safety

KONCEPTI I PËRBASHKËT I INTEGRUAR I
TRAJNIMIT DHE ARSIMIMIT NË SIGURI PUBLIKE NË
AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

Prill, 2025

1. AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) është e themeluar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- Policinë e Kosovës;
- Shërbimin Korrektues;
- Shërbimin Sprovues;
- Doganën e Kosovës;
- Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe
- Inspektoratin Policor të Kosovës.

AKSP është përgjegjëse për zhvillimin dhe ofrimin e programeve të trajnimit profesional. themelor, të avancuar, të specializuar si dhe të arsimit të lartë në fushën e sigurisë publike. Ky ligj përcakton **mandatin unik dhe rolin qendror të AKSP-së** në zhvillimin profesional të zyrtarëve të sigurisë publike, duke e vendosur atë në një pozitë të veçantë në sistemin institucional të Republikës së Kosovës. Kjo e bën AKSP-në mjaft unike në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke iu ofruar shërbimet e saj gjashtë institucioneve të sigurisë publike por që nuk kufizohet vetëm në këto institucione.

2. STATUSI INSTITUCIONAL I AKADEMISË SË KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

AKSP përfaqëson një model të veçantë institucional në rajon dhe më gjerë, për shkak të statusit të saj ndërinstitutional. Kjo e vendos AKSP-në në një pozitë unike mes strukturave shtetërore për siguri dhe sistemit të arsimit të lartë dhe profesional.

2.1 Akademia si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme

Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, AKSP është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme me kompetenca për ofrimin e trajnimit dhe arsimit të lartë në fushën e sigurisë publike. Ajo nuk është pjesë e institucioneve të sigurisë, por ushtron funksionin e trajnimit dhe arsimit të lartë për to.

Veçantia e këtij pozicionimi qëndron në faktin se:

- AKSP nuk është njësi e institucioneve të sigurisë, edhe pse ofron trajnime dhe arsim të lartë për institucionet e sigurisë publike;
- AKSP nuk është universitet publik, edhe pse ofron programe të arsimit të lartë;
- AKSP është institucion i veçantë, me karakter të ndërthurur mes trajnimit dhe arsimit të lartë.

Ky model ka për qëllim të ruajë neutralitetin institucional dhe të garantojë qasje të barabartë për të gjitha institucione e sigurisë publike, duke e pozicionuar AKSP-në si një qendër kombëtare arsimore për të gjitha këto institucione dhe jo vetëm si strukturë për një agjenci të vetme.

2.2. Statusi i Akademive të ngjashme në Evropë

Në Evropë, institucionet që ofrojnë trajnime dhe arsim të lartë për policinë dhe institucionet e tjera të sigurisë publike janë në varësi të Policisë apo të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në vijim paraqiten disa prej tyre për krahasim:

SHTETI	EMRI I INSTITUCIONIT	VARËSIA	LLOJI I ARSIMIT
Shqipëri	Akademia e Sigurisë	Policia e Shtetit	- Trajnime - Arsimit të lartë
Kroaci	Akademia Policore	Ministria e Punëve të Brendshme	- Trajnime - Arsimit të lartë
Bullgari	Akademia e Ministrisë së Brendshme	Ministria e Punëve të Brendshme	- Trajnime - Arsimit të lartë
Austri	Akademia e Sigurisë	Ministria Federale e Punëve të Brendshme	- Trajnime - Arsimit të lartë
Estoni	Akademia e Estonisë për Shkencat e Sigurisë	Ministria e Punëve të Brendshme	- Trajnime - Arsimit të lartë
Finland	Kolegji Universitar Policor	Policia	- Trajnime - Arsimit të lartë
Norvegji	Kolegji Universitar Policor	Ministria e Drejtësisë dhe Sigurisë Publike	- Trajnime - Arsimit të lartë

3. THELBI I KONCEPTIT TË PËRBASHKËT TË INTEGRUAR TË TRAJNIMIT DHE ARSIMIMIT TË INSTITUCIONEVE TË SIGURISË NË AKSP

Koncepti i përbashkët i integruar i trajnimit dhe arsimimit në siguri publike në AKSP është ndërtuar mbi nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse dhe të harmonizuar në përgatitjen e zyrtarëve të sigurisë publike në Kosovë.

Ky koncept nuk është vetëm një qasje organizative, por një filozofi zhvillimi profesional që synon të sigurojë cilësi, koherencë dhe efektivitet në përgatitjen e kuadrove të sigurisë, duke i bashkuar në një platformë të vetme trajnimin profesional, trajnimet themelore, të avancuara, të specializuara dhe arsimin e lartë.

Koncepti funksionon në tri nivele integrimi:

1. **Integrimi horizontal** – ndërmjet institucioneve dhe agjencive të ndryshme që trajnohen dhe arsimohet në AKSP, duke promovuar standarde të përbashkëta profesionale.
2. **Integrimi vertikal** – ndërmjet niveleve të ndryshme të përgatitjes: nga trajnimet bazë, te ato të avancuara dhe arsimimi i lartë.
3. **Integrimi funksional** – ndërmjet strukturave të brendshme të AKSP-së.

3.1. Institucion trajnues dhe arsimor unik dhe i vetëm në sigurinë publike

AKSP është themeluar si institucion i vetëm për trajnimin dhe arsimimin e të gjithë zyrtarëve të sigurisë publike në një vend. Ky koncept është bazuar në dy institucione simotra të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, konkretisht Hungarisë (*Universiteti për Shërbim Publik Ludovika, anglisht:*

Ludovika University of Public Service, linku: <https://en.uni-nke.hu>), dhe Estonisë (Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë, anglisht: Estonian Academy of Security Sciences, linku: <https://www.sisekaitse.ee/en>). Për më tepër, përmes zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në kontekstin evropian, nga AKSP është vërejtur se sistemet e ngjashme të ngritjes së kapaciteteve për disa institucione të sigurisë publike brenda një institucioni trajnues dhe arsimor ka edhe Malta (Akademia për Forcat e Disciplinuara, anglisht: Academy for Disciplined Forces Malta, linku: <https://academy.gov.mt>). Që të tri këto institucione janë mjaft kredibile dhe funksionale si rezultat i këtij koncepti. Kosova, së bashku me këto tri shtete anëtare të BE-së janë unike në hapësirën evropiane të trajnimit dhe arsimit në sigurinë publike. Prandaj, si rezultat i këtij koncepti, është në rritje interesimi për adaptimin e kësaj qasjeje në trajnimin dhe arsimimin e zyrtarëve të sigurisë publike. Rast konkret është Shqipëria, e cila ka bërë përpjekje për adaptimin e kësaj qasjeje në Akademinë e Sigurisë, ku AKSP ka qenë referencë suksesi duke marrë mësim nga ne në tri drejtime, në aspektin funksional, trajnues dhe të arsimit të lartë.

3.2. Kompletimi i kornizës institucionale për trajnimin e kapaciteteve të zyrtarëve të institucioneve shtetërore

Me krijimin e AKSP, është kompletuar korniza institucionale për arsimimin e zyrtarëve të institucioneve shtetërore, duke mbuluar të gjitha segmentet e fushave institucionale të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim:

INSTITUCIONI	FUSHA
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	përgjegjëse për fushën e sigurisë
Akademia e Drejtësisë	përgjegjëse për fushën e gjyqësorit
Akademia Diplomatike	përgjegjëse për fushën e shërbimit të jashtëm
Akademia e Mbrojtjes	përgjegjëse për fushën e mbrojtjes
Instituti i Kosovës për Administratë Publike	përgjegjëse për fushën e administratës publike

Për dallim nga institucionet trajnuese për zyrtarë të fushave të tjera si gjyqësori, shërbimi i jashtëm apo administrata publike, ku kriter për hyrje është përfundimi i studimeve në arsimin e lartë, në fushën e sigurisë publike jo gjithmonë kërkohet një diplomë universitare për pranimin fillestar. Për këtë arsye, **AKSP nuk është vetëm një institucion trajnues, por gjithashtu një institucion i arsimit të lartë**, që garanton një formim të plotë profesional dhe akademik të zyrtarëve të sigurisë publike, duke e plotësuar boshllëkun që ekziston në hyrjen dhe zhvillimin e karrierës në këtë sektor.

3.3. Punë e përbashkët e zyrtarëve të sigurisë – trajnim dhe arsimim i përbashkët

Në AKSP është adoptuar një qasje unike për trajnimin dhe arsimimin e zyrtarëve të sundimit të ligjit nisur nga besimi fundamental se nëse këta zyrtarë do të kenë punë të përbashkët në ofrimin e

sigurisë publike dhe zbatimit të ligjit atëherë pse edhe mos të trajnohen dhe arsimohen bashkërisht. Fushat e sigurisë publike janë të ndryshme por edhe kanë shume ngjashmëri, disa kanë më shumë të përbashkëta ndërsa disa më pak, por që bashkëpunimi dhe koordinimi mes tyre ndihmon në ofrimin e një ambienti të sigurtë në Republikën e Kosovës. Nëse trajnohen dhe arsimohen bashkë të gjithë zyrtarët e sigurisë publike kjo kontribuon në shumë dimensione. Në radhë të parë zyrtarët e agjencioneve të ndryshme të sigurisë publike e kuptojnë mandatin e njëra-tjetrës dhe nuk interferojnë në detyrat e njëra-tjetrës me pretekst se janë përgjegjëse. Në radhë të dytë krijohen rrjetet e bashkëpunimit e që në fushën e sigurisë publike luan rol të madh, përfshirë ofrimi i alternativave për sfidat që shpeshherë janë të ngjashme etj. Në radhë të tretë, shumë trajnime janë të ngjashme e që duhet ofruar për të gjitha agjencionet, p.sh. përdorimi i forcës, përdorimi i armëve, shkathtësitë fizike, ngasja emergjente, menaxhimi i vijës së parë, të mesme dhe ekzekutive si dhe trajnime të tjera. AKSP si institucioni unifikues në ngritjen e kapaciteteve të sigurisë publike ndikon në bashkërendimin dhe në krijimin e një kulture të përbashkët pune, e cila kultivohet gjatë trajnimit të përbashkët në AKSP. Rrjedhimisht në aspektin operativ gjatë kryerjes së mandatit të tyre si agjenci, duhet të bashkëveprojnë me njëra-tjetrën, si AME dhe PK (p.sh. fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, aksidente trafikut etj) apo PK dhe SHKK (ne ndonjë hetim ne burgje) apo PK dhe DK në pikat kufitare etj.

Trajnimi i përbashkët i zyrtarëve të sigurisë publike tashmë ka filluar të aplikohet si trend gjithandej p.sh. CEPOL dikur ka ofruar trajnime vetëm për policinë ndërsa sot ofron trajnime edhe për agjencione tjera si forenzika, prokuroria dhe gjyqësori, mbledhja e të ardhurave etj.

3.4. Efektiviteti i kostos

Kosova është vend i vogël në aspektin territorial dhe si rezultat i kësaj ka numër më të vogël të zyrtarëve të sigurisë në raport me vendet tjera. Andaj ky koncept për trajnimin dhe arsimimin e zyrtarëve të institucioneve përgjegjëse për rend dhe siguri publike, është një koncept i përshtatshëm për vendet e vogla siç është Kosova e qe Akademinë e bën shembull të mirë të qeverisjes dhe suksesit në shfrytëzimin racional të të mirave publike. Kosova nuk e ka komoditetin të krijojë institucione të trajnimit për secilën agjenci sepse do të krijonte kosto shtesë të panevojshme.

3.5. Institucion trajnues dhe arsimor ku të gjitha institucionet e sigurisë ndjehen komod

Krijimi i AKSP-së si akademi e sigurisë publike e jo akademi policore është bërë që të gjitha agjencionet e sigurisë publike ta ndiejnë si institucion të tyre dhe që asnjë agjencion të mos jetë mbizotërues ndaj njëra tjetrës. Kjo për faktin se agjencionet e sigurisë publike janë pjesë e ministrive të ndryshme andaj themelimi i akademisë si akademi e sigurisë publike ka bërë që të gjitha agjencionet e sigurisë publike të jenë të barabarta dhe secila ta ndiejë atë si shtëpi të veten trajnuese dhe arsimore.

3.6. Krijimi i një trupe trajnuese me zyrtarët e sigurisë publike duke racionalizuar stafin trajnues nëpër agjencione me qëllim të realizimit të funksioneve primare

Kosova ka një numër relativisht të vogël të zbatuesve të ligjit nëpër agjencione të ndryshme. Shkollimi i një zyrtari të sigurisë publike ka kosto shumë të lartë, andaj nevojitet që ky proces të racionalizohet me kosto sa ma të ultë në arritjen e qëllimit. Nëse një zbatues i ligjit nuk e ushtron

mandatin e tij primar që është zbatimi i ligjit, por angazhohen në fusha tjera (p.sh. në trajnime), kjo ndikon që shumë zyrtarë të sigurisë publike të mbesin jashtë funksionit primar për çka edhe janë të thirrur – zbatimin e ligjit.

Për këtë arsye fuqizimi i AKSP për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë do të sjell benefite sepse AKSP-së si një qendër e vetme unike dhe kompetente për ofrimin e trajnimeve në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike kontribon që numri i zyrtarëve të sigurisë publike të jetë më i madh në terren në ushtrimin e funksioneve të tyre primare. Në këtë aspekt, në AKSP do të krijohej një trupë trajnuese me zyrtarët e sigurisë publike që janë të domosdoshëm për ofrimin e trajnimeve në vazhdimësi, ndërsa pjesa tjetër do të angazhohej vetëm në kohë caktuar. Prandaj krijimi i një trupe trajnuese në secilin institucion të sigurisë publike do të ndikonte në zvogëlimin e burimeve njerëzore në ushtrimin e funksionit primar.

3.7. Vend i përbashkët i caktimit të standardeve të trajnimeve

AKSP është vendi i përbashkët i caktimit të standardeve të trajnimit. Kjo për faktin se përmes ligjit të Akademisë është krijuar Bordi i Akademisë sipas konceptit amerikan (me propozim të partnerëve amerikanë) me përbërje të drejtorëve të agjencive të sigurisë publike dhe Kryeprokurorit të shtetit me qëllim të caktimit të standardeve minimale profesionale dhe politikave trajnuese në fushën e sigurisë publike. Kjo nënkupton përcaktimin e një sërë kriteresh të dizajnuara për të ndihmuar në matjen e përshtatshmërisë së personit për t'i shërbyer popullit të Kosovës në cilësi të sigurisë publike. Ajo duhet të përfshijë standardet minimale të punësimit përkitazi me etikën personale, karakterin, trajnimin dhe kompetencën e personelit të sigurisë publike dhe Akademisë.

3.8. Infrastrukturë që plotëson nevojat trajnuese dhe arsimore

Për të ofruar trajnim dhe arsim cilësor për zbatues të ligjit nevojitet infrastrukturë që plotëson kushte optimale për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë. Në këtë drejtim, AKSP ka investuar në krijimin e hapësirave mësimore dhe pajisjeve përcjellëse që kampusi ti plotëson shumicën e nevojave për trajnimin dhe arsimimin e zyrtarëve të sigurisë publike.

Nëse për secilin Agjenci të Sigurisë Publike do të ishte ndërtuar nga një Qendër Trajnuese, do kishte kosto të përmasave të mëdha për shtetin. Andaj çdo investim në infrastrukturë dhe pajisje që shumicën e rasteve janë të ngjashme është racionale të shfrytëzohen në një institucion siç është AKSP-ja pasi përveç shfrytëzimit racional do ta minimizonte edhe koston e mirëmbajtjes.

3.9. Planifikimi dhe koordinimi i donacioneve për trajnime

AKSP do të shërbejë si institucion unik për koordinimin e donacioneve në pajisje dhe projekte trajnimi. Kjo nënkupton se të gjitha agjencionet mund të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga resurset e siguruar përmes donatorëve. Një qasje e centralizuar e bën më të lehtë komunikimin me donatorët, shmang dyfishimet dhe siguron që pajisjet apo trajnimet e dhuruara të përdoren nga sa më shumë zyrtarë. Në këtë mënyrë, donacionet bëhen më të qëndrueshme, të dobishme dhe të orientuara drejt nevojave reale.